

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË " Max Clinic " SH.P.K.**

Sot, me datë 09/01/2024

**Zj. Fjoralba Soukis**, shtetase Shqiptare, lindur më 21/10/1985 në Lunik, Shqiperi, mbajtëse i pasaportes me nr BD3881479 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

**Z. Kadir Burak Koza**, shtetas Shqiptar, lindur më 22/06/1977 në Turqi, mbajtës i leternjoftimit ID me nr 034239209 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Max Clinic**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Max Clinic**" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tirane, adresën: L+1 hyrja BC Arena center hyrja BC kati i pare rruga Dervish Hima Tirane Shqiperi.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**


**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria ka për objekt ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e mjekesise dhe shendetit në përputhje me autorizimet dhe akreditimet publike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

- Ofrimin e shërbimit të trajtimeve estetike, nderhyrjeve, mikrokirurgjise, mjekesise estetike (, trajtime me lazer, botox për rrudhat, rimodelim i buzeve, xantelazma hark plazmatik, trajtim me multivitamina, qepallat hark plazmatik, lifting i vetullave botox, rimodelim mollezave, mikrodermoabrazion, jawline contouring, filler për rrudhat, PRP për fytyrën dhe për flokët, rrathet e syve, white peeling, gummy smile, microneedling, radiofrekuenca, trajtimi i bruksizmit, mbushja e sulkuseve, trajtim celuliti, hark plazmatik, karboksiterapi, heqje tatuazhi, skleroterapi, hiperhidroze, lipolize etj. Trajtim flokesh, transplant flokesh etj.
- Ofrimin e shërbimit të turizimit spitalor

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe



të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1.000.000 Lek dhe është i ndarë në 3 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Fjoralba Soukis** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Z. Kadir Burak Koza** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Zj. Ada Bega**, shtetase Shqiptare, lindur më 05/07/1992 në Pogradec, Shqiperi, me ID J25705088D, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.


## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### ORTAKËT THEMELUES

**Zj. Fjoralba Soukis**

Fjoralba Soukis  


**Z. Kadir Burak Koza**

KADIR BURAK KOZA  
